



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Informimi i sotëm javor mbulon zhvillimet gjyqësore pak para fillimit të pushimit të gjykatës në fund të dhjetorit që përfundoi më 6 janar.

Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë* që u mbajt më 16 dhjetor, Trupi Gjyqësor bëri me dije synimin për të proceduar në këtë çështje gjyqësore me deklaratat hyrëse në fillim të marsit 2023. Trupi Gjyqësor njoftoi më tej se për ta mundësuar këtë, në muajin janar do të planifikohet një konferencë përgatitore për gjykimin, e cila do të ndiqet nga një konferencë përgatitore për Prokurorinë në muajin shkurt. Pasi të nxirren urdhrat për caktimin e datave të këtyre seancave, datat do të pasqyrohen në kalendarin e DHSK-së në internet.

Më 19 dhjetor, Trupi Gjyqësor në këtë çështje gjyqësore urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Trupi Gjyqësor konstatoi se rreziqet që z. Thaçi dhe z. Veseli të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor dhe/ose të kryejnë krime të tjera ekzistojnë ende dhe nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me anë të alternativave të tjera veç paraburgimit.

Më 22 dhjetor, Trupi Gjyqësor në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, nxori një Urdhër paraprak mbi Zhvillimin e Gjykimit. Urdhri, që gjendet në faqen e internetit të DHSK-së, trajton aspekte lidhur me zhvillimin e gjykimit, si hapat për mundësimin e procesit të drejtë dhe të shpejtë, gjuhën e punës të çështjes gjyqësore, nxjerrjen e materialeve, redaktimet, dëshmitë e dëshmitarëve si dhe aspekte të tjera. Trupi Gjyqësor urdhëroi palët dhe pjesëmarrësit në këtë çështje gjyqësore të dorëzojnë parashtrime apo kundërshtime me shkrim sa u takon propozimeve në urdhrin paraprak, brenda 13 janarit 2022.

Më 27 dhjetor 2022, Paneli i Apelit rrëzoi apelet e ekipeve të Mbrojtjes së Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit ku kundërshtonin pjesë të vendimit të mëhershëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontaktin e palëve me dëshmitarët e palës kundërshtare.

Më 28 dhjetor, Administratorja njoftoi Trupin Gjyqësor se kishte caktuar dy mbrojtës për të përfaqësuar viktimat parashtruese, të cilëve në Vendimin e Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave u ishte rrëzuar kërkesa për të marrë pjesë në procesin gjyqësor. Në këtë Vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi 21 viktimat pjesëmarrëse shtesë dhe rrëzoi 20 kërkesa të tjera. Sipas Rregullores, parashtruesve që u është rrëzuar kërkesa kanë të drejtën e apelimit.





Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 6 janar u bë publik një Vendim i mëhershëm mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë. Mbrojtja e Thaçit i ka kërkuar leje Trupit Gjyqësor të apelojë këtë Vendim.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, në vijim të shqiptimit të aktgjykimit të Trupit Gjyqësor më 16 dhjetor, Mbrojtja kërkoi zgjatje të afatit për dorëzimin e njoftimit për apel. Kryetarja e DHSK-së caktoi më 3 janar Panelin e Gjykatës së Apelit që përbëhet nga Gjykatësja Mishelë Pikar, Gjykatësi Kai Ambos dhe Gjykatësja Nina Jorgensen. Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e Mbrojtjes, pjesërisht, dhe autorizoi Mbrojtjen dhe Prokurorinë të dorëzojnë njoftimet për apel, nëse kanë, brenda 3 shkurtit 2023.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 11 janar Trupi Gjyqësor rrëzoi kërkesën e Prokurorisë për kufizimin e komunikimeve të z. Shala përpara fillimit të gjyqimit. Trupi Gjyqësor nuk u bind se masat e kërkuara do të ishin proporcionale.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

